

**UDHËZIM**  
**Nr. 8, datë 21.2.2013**

**PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 26, DATË 4.9.2008 “PËR TAKSAT KOMBËTARE”,  
TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të dekretit të Presidentit nr. 7767, datë 1.10.2012 dhe të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, Ministri i Financave

**UDHËZON:**

1. Në pikën 2.8.1, paragrafi i fundit ndryshon me këtë përmbajtje:

“Për ambalazhet njëpërdorimshme të plastikës dhe të qelqit të prodhuara brenda vendit, prodhuesi paguan në bankën e nivelit të dytë për llogari të drejtorisë rajonale ku është regjistruar, taksën për të gjithë sasinë e shitur, brenda datës 5 të muajit pasardhës. Prodhuesi duhet të plotësojë e të dorëzojë në drejtorinë rajonale tatimore ku është regjistruar, formularin nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, duke deklaruar sasinë e shitur dhe duke i bashkëlidhur mandatpagesën për taksën e paguar.”.

2. Në pikën 2.8.2, gerrat “b”, “c” dhe “ç” bëhen:

“b) “Ambalazh njëpërdorimësh” për qëllime të këtij udhëzimi do të konsiderohen ato ambalazhe që nuk i nënshtrohen regjimit të lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë sipas nenit 161 të ligjit nr. 8429, datë 27.1.1999 “Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë” dhe të pikave 3 dhe 4 të nenit 349 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 13.4.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar dhe që shërbejnë për paketimin, ruajtjen e produkteve të parashikuara në anekset 1 dhe 2 të ligjit për taksat kombëtare nr. 7767, datë 1.10.2012, të ndryshuar dhe që përdoren vetëm një herë.

c) “Ambalazh plastik njëpërdorimësh” janë ambalazhet njëpërdorimshme sipas përkufizimit të gurmës “b” më lart dhe që klasifikohen në kodet 3923 dhe 392410 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave në rastet kur importohen veçmas dhe shërbejnë për të paketuar produkte të parashikuara në aneksin 1 të ligjit 83/2012 dhe ambalazhet që ruajnë dhe paketojnë mallrat e listuara në tabelën 2 në aneksin 1 të ligjit 83/2012 dhe zë të paktën 51% të masës së përgjithshme të ambalazhit. Në kuptim të kësaj pike, nuk do të konsiderohen ambalazhe njëpërdorimshme plastike artikujt, si më poshtë:

- i) arkat plastike;
- ii) fuçitë me kapacitet  $\geq 20$  litra;
- iii) kapakët e CD dhe DVD;
- iv) kutitë paketuese dhe tasat për ushqime;
- v) kutitë e votimit;
- vi) tabakatë plastike;
- vii) mbajtëset për kafe, çaj, erëza;
- viii) sallatierat, supierat;
- ix) kuti mbajtëse për rroba, kapëse rrobash;
- x) mbajtëset e artikujve të kuzhinës, si: lugë, thika, pirunë etj.;
- xi) mbajtëset për ushqimet, si: marmelatë, bukë, salcë, fruta, gjalpë, vaj etj.;
- xii) tabaka;
- xiii) vazot e luleve.

ç) “Ambalazh qelqi njëpërdorimësh” janë ambalazhet njëpërdorimshme sipas përkufizimit të gurmës “b” më lart dhe që klasifikohen në kodet 7010 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave në rastet kur importohen veçmas dhe shërbejnë për të paketuar produkte të parashikuara në tabelën 2 në aneksin 2 të ligjit 83/2012 dhe ambalazhet që ruajnë dhe paketojnë mallrat e listuara në tabelën 2 në aneksin 2 të ligjit 83/2012 dhe zë të paktën 80% të masës së përgjithshme të ambalazhit. Në kuptim të kësaj pike, nuk do të konsiderohen ambalazhe njëpërdorimshme qelqi artikujt, si më poshtë:

- i) damixhanë;

- ii) enë qelqi (jo shishe) për ruajtjen e produkteve ushqimore;
  - iii) mbajtëset për kafe, çaj, erëza;
  - iv) mbajtëset për ushqimet, si: marmelatë, bukë, salcë, fruta, gjalpë, vaj etj.;"
- Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE  
**Ridvan Bode**